

ePeriodik

PUBLIKIM MUJOR, Numri 159, Gusht 2022

Vështrim mbi tregjet

- Ecuria e tregut të sigurimeve në Shqipëri, Janar–Korrik 2022

Zhvillime të tjera

- AMF publikon “Gjeografia e Sigurimeve 2021”
- Konsultim publik për projektregulloren "Për mjaftueshmërinë e kapitalit të shoqërisë komisionere“

Publikime Profesionale

- IOSCO Java Botërore e Investitorit do të zhvillohet 3-9 tetor 2022
Publikohet studimi “Edukimi i investitorëve në kontekstin e tregjeve dhe produkteve të qëndrueshme financiare
- Menaxhimi i Rrezikut në Institucionet Financiare - Volumi 15, Nr. 3

Informacione Ndërkombëtare

Bullgari
Maqedoni e Veriut

Kosovë
Slloveni

Kroaci

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

VËSHTRIM MBI TREGJET

Ecuria e tregut të sigurimeve në Shqipëri, Janar–Korrik 2022


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-korrik 2022 kapën vlerën 11,867 milionë lekë, ose 8.51% më shumë se në janar-korrik 2021. Gjatë periudhës janar-korrik 2022, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 705,545 me një rritje prej 17.3% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.54% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 8.36%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 41.12% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 58.88% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-korrik 2022, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 3,703 milionë lekë, ose 12.77% më pak se në periudhën janar-korrik 2021.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar-korrik 2022 kapën vlerën 2,520 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 5.61% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Struktura e tregut të sigurimeve, Janar–Korrik 2022 (Në %)



Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar-korrik 2022 kapën vlerën 2,520 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 5.61% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

ZHVILLIME TË TJERA

AMF publikon “Gjeografia e Sigurimeve 2021”



Gjeografia e Sigurimeve 2021, pasqyron në mënyrë të detajuar shpërndarjen e primeve të shkruara bruto, dëmeve të paguara si edhe primit për frymë, sipas prefekturave.

Duke analizuar shpërndarjen gjeografike të primit të shkruar bruto, vërehet një përqendrim i tregut të sigurimeve në prefekturat e mëdha, si Tirana me 60.50% të totalit të primeve të shkruara bruto gjatë vitit 2021, Durrësi me 7.39%, Fieri 4.98%, Shkodra 4.63% dhe Korça 4.47%. Kjo tendencë përqendrimi ka vijuar e tillë për një periudhë 14-vjeçare.

Një tregues tjetër i rëndësishëm i tregut të sigurimeve është dendësia e sigurimeve. Për vitin 2021 ky tregues është rreth 6,887 lekë për frymë, me një rritje rreth 1,023 lekë krahasuar me një vit më parë.

Gjeografia e tregut të sigurimeve për vitin 2021 gjendet në:

<https://amf.gov.al/statistika.asp?id=4>

Përsa i përket primit për frymë sipas prefekturave, prefektura Tiranë me 12,660 lekë për frymë zë vendin e parë, e pasuar nga prefektura Gjirokastrë me 6,227 lekë për frymë dhe më tej Durrësi me 4,879 lekë për frymë, Vlora me 4,624 lekë për frymë dhe Shkodra me 4,614 lekë për frymë.

Ky publikim përfshin gjithashtu edhe informacion të hollësishëm për dëmet e paguara gjatë vitit 2021 sipas prefekturave, duke krijuar edhe mundësinë e krahasimit të këtyre treguesve me ato të një viti më parë. Përsëri pjesën më të madhe të dëmeve të paguara e ka prefektura e Tiranës me 70.02%, e pasuar nga prefektura Durrësi me 8.99%.

AMF nxjerr për konsultim publik projektregulloren "Për mjaftueshmërinë e kapitalit të shoqërisë komisionere"



Projektregullorja
gjendet në:

[https://amf.gov.al/pdf/fokus/
Projektregullore.pdf](https://amf.gov.al/pdf/fokus/Projektregullore.pdf)

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 62/2020, datë 14.05.2020 "Për Tregjet e Kapitalit", ka hartuar projektregulloren "Për mjaftueshmërinë e kapitalit të shoqërisë komisionere".

PUBLIKIME PROFESIONALE

IOSCO - Java Botërore e Investitorit do të zhvillohet 3-9 tetor 2022



Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Titujve, IOSCO, do të mbështesë për të gjashtin vit rradhazi Javën Botërore të Investitorëve (WIW), nga 3 deri më 9 tetor 2022.


Dy temat kryesore të aktiviteteve që do të zhvillohen gjatë kësaj jave ndërkombëtare lidhen me rimëkëmbjen e investitorëve dhe elasticitetin e tyre, si edhe financimin e qëndrueshëm.

Si pjesë e përgatitjeve për këtë javë, IOSCO publikoi Raportin Publik mbi “Javën Botërore të Investitorëve - 2021”. Raporti përshkruan shembuj realë të shumëllojshmërisë së aktiviteteve të organizuara dhe të kryera nga juridiksione të ndryshme pjesëmarrëse në vitin 2021, duke ofruar kështu një udhëzues të dobishëm për larminë e aktiviteteve që juridiksionet pjesëmarrëse mund të ndërmarrin gjatë vitit 2022.

Megjithëse fushata e vitit të kaluar u zhvillua në kushtet e rrepta të vendosura nga pandemia Covid-19, juridiksionet pjesëmarrëse përshtatën formatin e fushatave ndërgjegjësuese sipas rrethanave të tyre (p.sh., duke përdorur një format virtual në disa raste ose duke ofruar aktivitete personalisht, në raste të tjera). Për më tepër, pjesëmarrës të ndryshëm përfituan nga fushata WIW për të shpallur iniciativa të rëndësishme lokale për të rritur edukimin e investitorëve dhe mbrojtjen e investitorëve.

vijon ...

... vijon


www.worldinvestorweek.org

Jose Vasco, Koordinator i Grupit të Punës të WIW, tha: "Java Botërore e Investitorëve të IOSCO-s është një fushatë gjithëpërfshirëse që përfshin gjithnjë e më shumë aktorë të ndryshëm, nga Bankat Qendrore dhe Ministrinë e Financave të ndërmjetësit financiarë dhe këshilltarët në universitete dhe shkolla. Gjithëpërfshirja është e rëndësishme, pasi kjo fushatë është një përpjekje ndërsektoriale që synon të promovojë edukimin dhe mbrojtjen e investitorëve, si edhe të përpiqet të arrijë tek investitorët aktualë dhe potencialë."

"Martin Moloney, Sekretari i Përgjithshëm i IOSCO, tha: "Promovimi i edukimit të investitorëve është i rëndësishëm në rrethana normale, por është veçanërisht i rëndësishëm në kohë stresi. Në kontekstin aktual, investitorët përballen me rreziqe të përkeqësuar nga konfliktet gjeopolitike, tendencat inflacioniste dhe pasiguria mbi evoluimin e ngjarjeve aktuale, ndër sfida të tjera. Edukimi financiar është një mjet për të ndihmuar investitorët me pakicë të perceptojnë rreziqet dhe mundësitë që hasin dhe i ndihmon ata të mbrohen nga mashtrimet, të jenë financiarisht elastikë dhe të shmangin rreziqet e panevojshme."

Faqja e internetit e Javës Botërore të Investitorëve www.worldinvestorweek.org ofron informacion shtesë mbi fushatën për vitin 2022, duke përfshirë mënyrën se si të merrni pjesë në këtë fushatë globale.

Publikohet studimi i IOSCO “Edukimi i investitorëve në kontekstin e tregjeve dhe produkteve të qëndrueshme financiare”



OICU-IOSCO

INTERNATIONAL ORGANIZATION OF SECURITIES COMMISSIONS

Edukimi mbi financat e qëndrueshme ndihmon në mbrojtjen e investitorëve kundër mashtrimit dhe *greenwashing**

Bordi i Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Titujve (IOSCO) publikoi një raport që identifikon zhvillimet më të fundit në edukimin e investitorëve mbi financat e qëndrueshme, me synimin për të rritur edukimin dhe mbrojtjen e investitorëve dhe mbështetjen e zhvillimit të shëndoshë të këtij tregu financiar në rritje.

Raporti mbi edukimin e investitorëve me pakicë, në kontekstin e tregjeve dhe produkteve të qëndrueshme financiare, tregon se rregullatorët e titujve janë fokusuar gjithnjë e më shumë tek fakti nëse pretendimet për financim të qëndrueshëm janë të sakta dhe nëse investitorët kanë informacionin që u nevojitet për të vlerësuar produktet e qëndrueshme financiare. Për të marrë vendime të informuara, investitorët me pakicë duhet të kuptojnë karakteristikat e produkteve të tilla.

Në përputhje me këto, raporti identifikon disa nga sfidat kryesore dhe praktikatat e mira për zhvillimin e përmbajtjes edukative për këto çështje, informimin e investitorëve për veçoritë dhe rreziqet e investimeve të qëndrueshme dhe nxitjen e aktiviteteve arsimore/edukative që krijojnë kushtet për mbrojtjen dhe informimin më të mirë të investitorëve me pakicë mbi mundësitë dhe rreziqet që lidhen me produktet financiare të qëndrueshme. Raporti përshkruan aktivitetet edukative që rregullatorët duhet të marrin në konsideratë, duke marrë parasysh nivelin e financimit të qëndrueshëm dhe pjesëmarrjen e investitorëve me pakicë në këto tregje. Kjo përfshin, për shembull:

- Shpjegimin për investitorët me pakicë se si të marrin informacion në lidhje me qëndrueshmërinë, të kërkojnë dhe të kuptojnë nëse produkti(et) i ofruar përputhet me preferencat e tyre lidhur me qëndrueshmërinë; dhe
- Mbështetjen e nismave të pjesëmarrësve të tregut për të ndihmuar investitorët me pakicë të kuptojnë se cilat janë kriteret financiare që lidhen edhe me ruajtjen e parametrave ESG (Mjedisi, Sociale dhe Qeverisja). Gjithashtu mbështetja për inkurajimin dhe/ose lehtësimin e trajnimeve që i ndihmon këshilltarët financiarë të kuptojnë më mirë *greenwashing* dhe si të mbrojnë investitorët ndaj pretendimeve të pabazuara ose mashtruese të qëndrueshmërisë.

* *Greenwashing* është një formë e marketingut mashtrues, në të cilën një kompani, produkt ose praktikë biznesi promovohet në mënyrë të rreme sikur është shumë miqësore me mjedisin.

Materiali i plotë gjendet në:

<https://www.iosco.org/news/pdf/IOSCONEWS656.pdf>

Publikohet studimi i IOSCO "Edukimi i investitorëve me pakicë në kontekstin e tregjeve dhe produkteve të qëndrueshme financiare"



Vijon ...

Raporti plotëson përpjekjet e tjera të IOSCO-s në këtë fushë, duke përfshirë punën e Grupit të Punës për Financat e Qëndrueshme (STF), e cila ka rekomanduar që "Rregullatorët e titujve dhe/ose politikëbërësit, sipas rastit, të marrin në konsideratë promovimin e iniciativave financiare dhe edukimin e investitorëve në lidhje me qëndrueshmërinë, ose, aty ku është e mundur, të përmirësojnë iniciativat ekzistuese arsimore të lidhura me qëndrueshmërinë." **

Raporti përfshin disa mesazhe kryesore që rregullatorët e titujve duhet të marrin në konsideratë për programet e tyre të edukimit financiar, për të ndihmuar investitorët me pakicë të kuptojnë se si do të silllet një "investitor i zgjuar" kur përballet me produkte të qëndrueshme financiare.

Ashley Alder, Kryetar i Bordit të IOSCO-s dhe Drejtor Ekzekutiv i Komisionit të Titujve të Hong Kongut, tha: "Edukimi financiar është një element kyç për të rritur mbrojtjen e investitorëve dhe ai plotëson politikat, rregulloret, mbikëqyrjen dhe veprimet që rregullatorët mund të marrin përsipër të mbështesin zhvillimin e shëndoshë dhe të duhur të tregjeve dhe produkteve të qëndrueshme financiare. Edukimi financiar gjithashtu rrit besimin e investitorëve për të marrë pjesë në tregje financiare novatore, të tilla si financat e qëndrueshme, mbi një bazë të informuar siç duhet."

Pasquale Munafò, Kryetar i Komitetit të IOSCO-s për Investitorët me Pakicë, tha: "Financat e qëndrueshme ofrojnë mundësi të reja për investitorët me pakicë, në nivel lokal dhe global. Por është thelbësore që ata të kuptojnë se çfarë është një produkt i qëndrueshëm, si dhe mundësitë dhe rreziqet e ndryshme të tij, duke përfshirë kërcënimin e *greenwashing*. Raporti synon të ofrojë mjete praktike dhe mesazhe për të mbështetur edukimin financiar, por ky është vetëm fillim i punës, pasi financat e qëndrueshme vazhdojnë të zhvillohen në mbarë botën."

** "Raporti i IOSCO-s mbi Rekomandimet mbi Praktikat, Politikat, Procedurat dhe Shpalosjen në Menaxhimin e Aseteve që lidhen me Qëndrueshmërinë", nëntor 2021.



Materiali i plotë gjendet në

<https://www.iosco.org/news/pdf/IOSCONEWS656.pdf>



Volume 15 (2022)

SUBSCRIBE NOW >


Each volume of *Journal of Risk Management in Financial Institutions* consists of four 100-page issues, published both in print and online. Articles scheduled for Volume 15 are available to view on the [Forthcoming content](#) page.

The papers and case studies confirmed for Volume 15 are listed below:

[Volume 15 Number 1](#)

Special Issue: *Advances in ESG: Integration, risk management and thematic investing*


Guest Editors: *Dr. Luis Seco, CEO, Sigma Analysis & Management, Professor of Mathematical Finance, University of Toronto and Alik Sokolov, CEO, SR.ai, PhD Candidate, Mathematical Finance, University of Toronto*



Revista “Menaxhimi i Riskut në Institucionet Financiare” (*Journal of Risk Management in Financial Institutions*) Vëllimi 15, (2022) Numri 1 henrystewartpublications.com

Ky numër përmban ndër të tjera edhe artikujt e mëposhtëm:

- Editorial - “Progresi për ESG (*Environment, Social, Governance*): Integrimi, menaxhimi i riskut dhe investimi tematik”, - Dr. Luis Seco, CEO, Sigma Analysis & Management, Profesor i Financës Matematikore, Universiteti i Torontos dhe Alik Sokolov, CEO, SR.ai, Ph.D kandidat, Financa matematike, Universiteti i Torontos.
- Opinion - “A po ndikon investimi i ESG në kalimin drejt një ekonomie të qëndrueshme apo në keqshpërndarjet më të mëdha të kapitalit dhe një mundësi e humbur?” – Dr. Madelyn Antoncic, Anëtare e Bordit të Drejtorëve ACWA POWER, Arabia Saudite; S&P Global Ratings & FinTech Acquisition Corp VI, SHBA.
- “Si mund të zbatohet testimi i stresit për rrezikun klimatik?” - Greg Hopper, Drejtor Menaxhues, Goldman Sachs
- “Përcaktimi sasior i pasigurisë së rrezikut klimatik në mjediset konkurruese të biznesit.” - Jorge R. Sobehart, Drejtor Menaxhues dhe Drejtor i Analitikës së Riskut të Kredisë dhe Obligorit, Citi
- “Menaxhimi i rreziqeve të ndryshimeve klimatike: Roli i qeverisjes dhe analizës së skenarit.” - Laurent Clerc, Drejtor për Kërkimin dhe Analizën e Riskut, Autorité de Contrôle Prudentiel et de Resolution.
- “Si të përmirësohet profili ESG i portofoleve duke mbajtur një kthim të ngjashëm të rregulluar nga rreziku.” - Antoine Kopp, Dominic Barbe, Rémy Cottet dhe Gabriele Susinno, Pictet Asset Management
- “ESG si input për një shtresë mbrojtëse të qëndrueshmërisë së kapitalit.” - Martin Neisen, Partner, Benjamin Bruhn, Menaxher dhe Dieter Lienland, Drejtor, PricewaterhouseCoopers
- “Rreziku i ndryshimit të klimës: Kufiri tjetër në menaxhimin e rrezikut bankar.” - Hanna Sarraf, Zyrtare Shefe e Riskut e Grupit, Bankmed Group
- “Të bëhesh pjesë e tavolinës së diskutimeve për ESG.” - Jonny Frank, Partner, Jim Barolak, Partner dhe Germari Pieterse, Drejtor Menaxhues, StoneTurn



Volume 15 (2022)

[SUBSCRIBE NOW >](#)


Each volume of *Journal of Risk Management in Financial Institutions* consists of four 100-page issues, published both in print and online. Articles scheduled for Volume 15 are available to view on the [Forthcoming content](#) page.

The papers and case studies confirmed for Volume 15 are listed below:

Volume 15 Number 1

Special Issue: Advances in ESG: Integration, risk management and thematic investing

Guest Editors: Dr. Luis Seco, CEO, Sigma Analysis & Management, Professor of Mathematical Finance, University of Toronto and Alik Sokolov, CEO, SR.ai, PhD Candidate, Mathematical Finance, University of Toronto



Revista “Menaxhimi i Riskut në Institucionet Financiare”
(*Journal of Risk Management in Financial Institutions*)
Vëllimi 15, (2022) Numri 1

www.henrystewartpublications.com/jrm/v15

“Menaxhimi i rreziqeve të ndryshimeve klimatike: Roli i qeverisjes dhe analizës së skenarit.” - Laurent Clerc, Drejtor për Kërkimin dhe Analizën e Riskut pranë Autoritetit të Kontrollit të Kujdesshëm dhe Rezolucionit, Francë

Abstrakt:

Ndryshimet klimatike dhe rreziqet mjedisore, siç ilustron nga ngjarjet ekstreme të motit dhe humbjet e biodiversitetit, përbëjnë një kërcënim themelor për njerëzimin.

Thirrjet për veprim janë intensifikuar dhe presionet në sektorin financiar janë rritur ndjeshëm. Si rezultat, pasqyrimi i treguesve mjedisorë, socialë dhe të qeverisjes (ESG) dhe vlerësimi i rrezikut janë përmirësuar.

Në këtë kontekst, ky dokument thekson rolin vendimtar të qeverisjes dhe analizës së skenarëve në rritjen e efektivitetit të menaxhimit të rrezikut mjedisor dhe ndryshimeve klimatike. Në dokument janë dhënë shembuj konkretë, duke u mbështetur në disa rezultate të fazës pilot të projektit të klimës nga Autoriteti Frances i Mbikëqyrjes së Kujdesshme, ACPR (*French Prudential Supervision and Resolution Authority*) për të ilustruar rëndësinë e analizës së skenarëve.

Fjalët kyçe: ESG, ndryshimi i klimës, menaxhimi i rrezikut, qeverisja, testimi i stresit, analiza e skenarit.

BULLGARI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave nga Shoqata e Siguruesve Bullgarë (ABZ), pjesa e sigurimeve bujqësore në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës, edhe pse mjaft e vogël, ka rënë katër herë brenda një viti, nga 0.74% në mars 2021, në 0.19% në mars 2022.

Nina Kolchakova, Sekretare e Përgjithshme e ABZ tha se vëllimi i primeve të shkruara bruto për sigurimin bujqësor ishte rreth 1.3 milionë BGN ose rreth 0.66 milionë euro. Kjo rënie është kombinuar edhe me një rritje të fortë të dëmeve të paguara prej 85% në mars 2022. Rritja e dëmeve të paguara shpjegohet me ndryshimet klimatike, të cilat çojnë në fenomene ekstreme si breshri i shpeshtë dhe i fortë, thatësira dhe zjarret.

Megjithatë, ndërsa rreziqet janë në rritje, sigurimet bujqësore po bien. Sipas Nina Kolchakova, Sekretare e Përgjithshme e ABZ, është e vështirë të jepet një shpjegim i saktë dhe i qartë për arsyet. Midis tyre mund të jetë perceptimi i përhapur mes fermerëve se siguri është i shtrenjtë dhe më tepër një shpenzim i panevojshëm, pasi ata besojnë në mbështetjen e shtetit në rast dëmtimi. Pritshmëria që shteti të detyrohet të dëmshpërblejë fermerët sjell edhe disa probleme. Prodhuesit shpesh nuk e kuptojnë se kushti është që 100% e të korrave të ketë dështuar, dhe kjo nuk ndodh gjithnjë kështu. Nuk ka para për të mbuluar plotësisht humbjet, shpjegoi ajo.

Ekziston edhe një efekt tjetër negativ në aspektin thjesht ekonomik. Siguruesit e shpërndajnë rrezikun midis një rrethi të vogël prodhuesish bujqësorë, për rrjedhojë çmimi i sigurimit është më i lartë. Hulumtimet e dy viteve më parë tregojnë se vetëm 6% e sipërfaqeve bujqësore në vend janë të siguruara. Tashmë kjo përqindje mund të jetë edhe më e ulët, duke pasur parasysh rënien e të ardhurave nga primi për këtë lloj siguri.

KOSOVË

www.xprimm.com

Sipas publikimit “Sistemi Financiar – Informacioni Mujor” në faqen e Bankës Qendrore të Kosovës, vëllimi i primeve të shkruara bruto në tregun e sigurimeve në Kosovë në gjashtëmujorin e parë 2022 arriti në 61.5 milionë euro kundrejt, nga 55.3 milionë euro që ishte në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Sigurimet e Jetës zinin 3.4 milionë euro, ndërsa sigurimet e Jo-Jetës arritën në 58.1 milionë euro, me një rritje vjetore prej 9.5%.

12 siguruesit aktivë të Kosovës raportuan një fitim neto total prej 2.5 milionë euro në fund të qershorit 2022, kundrejt 1.5 milionë euro një vit më parë. Në të njëjtën kohë, totali i aktiveve të siguruesve u rrit në 253.6 milionë euro, nga 230 milionë euro një vit më parë.

KROACI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të Byrosë Kroate të Sigurimeve (CIB) vëllimi i primeve të shkruara bruto të siguruesve kroatë, në gjysmën e parë të 2022, u rrit me 7.53%, duke arritur në 6.88 miliardë HRK ose rreth 915 milionë euro. Primet e sigurimit të Jo-Jetës u rritën me 10.9% duke arritur në 5.34 miliardë HRK (rreth 710 milionë euro), ndërsa primet e sigurimit të Jetës u ulën me 2.8%, duke arritur në 1.54 miliardë HRK.

MAQEDONI E VERIUT

www.xprimm.com

Sipas shifrave të tregut të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë, siguruesit maqedonas realizuan një vëllim të primeve të shkruara bruto me vlerë 6.5 miliardë dinarë, ose rreth 105 milionë euro për periudhën janar-qershor 2022. Kjo shifër shpreh një rritje prej 9.4% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Primet e shkruara bruto të sigurimeve të Jo-Jetës përbëjnë 83.5% të totalit të primeve duke arritur në 5.4 miliardë dinarë, ose rreth 87.5 milionë euro. Në sigurimet e Jo-Jetës, pjesën më të madhe e zinin sigurimet e MTPL-së me 37.1% të totalit dhe sigurimi i pronës me 20.1% të totalit.

SLLOVENI

www.xprimm.com

Siguruesit slovenë, në fund të tremujorit të parë të 2022, raportuan një rritje të primeve të shkruara bruto me 5.08%, (e shprehur në terma vjetore) duke arritur në 762.2 milionë euro. Përcaktuesi i tendencës rritëse ishte segmenti i Jo-Jetës, i cili siguron rreth 93% të vëllimit të primeve. Gjatë tremujorit të parë të vitit 2022 u rritën edhe dëmet e paguara me rreth 12.6%, duke arritur në 453.7 milionë euro, rritje kjo kryesisht e nxitur nga sigurimet shëndetësore.

Në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës, sigurimi i pasurisë - në veçanti "dëmtimet e pronës" dhe sigurimi motorik, sidomos Sigurimi Kasko, ishin kontribuuesit kryesorë në rritjen e vëllimit të primeve.

Sigurimet e Jetës patën në përgjithësi, një rritje më të lehtë prej 1.3% të primeve, duke arritur në 197.6 milionë euro. Më e dallueshme ishte rritja në klasën e sigurimeve të Jetës të lidhura me skemat e kursimeve, *Unit-Linked Products*, e cila pati një rritje prej 11.26% të primeve, duke arritur në 78.6 milionë euro.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al